

VENDIM
Nr.20, datë 9.3.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË MIRATIMIT TË RREGULLORES PËR
PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, nenit 18 pika 1 germa “g”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.6.2008 “Për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike” pika III.1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregulator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2009, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e OST sh.a. “Për miratimin e rregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e rregullores “Për Procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta